


E HENE, GUSHT 31, 2015

- [21 WEB](#)
- [21 PLUS](#)
- [21 MIX](#)
- [21 BUSSINESS](#)
- [RADIO 21](#)
- [21 YOUTUBE](#)
- [21 JUNIOR](#)



[BALLINA](#)

[LAJME](#)

[EKONOMI](#)

[SPORT](#)

[KULTURË](#)

[OPINIONE](#)

[INTERVISTA](#)

TË TJERA

21 WEBTV

Fillimi [Ekonomi](#) [Biznes](#) Kusari-Lila : Të shfrytëzojmë çdo pëllëmbë toke për zhvillimin e bujqësisë



- [EKONOMI](#)
- [BIZNES](#)

Kusari-Lila : Të shfrytëzojmë çdo pëllëmbë toke për zhvillimin e bujqësisë

Gush 27, 2015

SHPËRNDAJE**Facebook****Twitter**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari Lila ka marr pjesë sot në organizimin e ditës fushore dhe ditës së exportit të perimeve në Kosovë, e cila u mbajt në Gjakovë. Ky aktivitet u organizua me qëllim të promovimit të prodhimeve permitare nga regjioni i Gjakovës , promovimin e varieteteve te reja te prodhimeve permitare (spec, domate, tranguj, etj.), si dhe promovimin e inputeve bujqesore sipas standarteve.

Në fjalës e saj, Kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila tha se me kënaqësi sot ndodhet në mesin e fermerëve për ti inkurajuar ata që të vazhdojnë më tutje me punën e tyre të vlefshme. "Shpresoj që nga dita në ditë në tregun tonë të shohim më shumë produkte kosovare dhe të shfrytëzojmë çdo pëllëmb toke në mënyrën më të mirë të mundshme në mënyrë që të kemi edhe ngritje të exportit në vendet e zhvilluara. Vetëm të organizuar me bashkëpunim të qeverisë qendrore, kuvendit komunal dhe shoqatave mund të arrijmë të kemi një bujqësi të zhvilluar", tha ndër të tjera Kryetarja Mimoza Kusari Lila cila njëherësh falenderoj edhe organizatat ndërkombëtare, qeverinë amerikane, qeverinë zvicerane dhe organizatat tjera për fokusin dhe vëmendjen e veçantë që po i kushtojnë zhvillimit të bujqësisë.

Në emër të qendrës grumbulluese të pemëve dhe perimeve "Agrocelina", foli menaxheri z.Feim Rexhepi i cili tha se promovimi i prodhimeve Kosovare ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik, pasi që me ngritjen e nivelit të exportit drejtëpërsëdrejti ngritet edhe hapsira për vende të reja të punës në lëmin e bujqësisë.

Në fund Kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari – Lila vizitoi edhe fushat demonstruese duke parë nga afër edhe varietetet e reja të perimtarisë.